



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U**  
**PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA**

Nr.regj. 16953/10

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, Gjyqtari Ali Latifi me pjesmarrjen e procesmbajtës shemsije Lumi, sekretare juridike duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Imer Berisha nga Prishtinë për kundërvajtje nga neni 16.paragrafi 1.1 të Ligjit për deklarativin e prejadhjen dhe kontrollin e pasuris dhe të dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe neni 200 të LMK-së me dt. 20.10.2010, merrë këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI:** Imer Berisha i punësuar në Ministrin e Punëve të Jashme të Republikës së Kosovës.

### **Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse me dt.22.03.2010, si zyrtar i lartë publik është punësuar në Ministrin e Punëve të Jashme të Republikës së Kosovës, dhe nga Agjensioni për antikorrupsion nuk e ka dërguar formularin për deklarimin e pasuris edhe pse i jan dërguar formularët e Agjensionit për antikorrupsion, në formë fizike dhe elektronike. Me ç,ka ka kryer kundërvajtje nga neni 16.paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, prejadhjen dhe kontrollin e pasuris dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, andaj për këtë

## **G J O B I T E T**

**Me gjobë në shumë prej 1000 (Njëmijë) €**, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë në favor të AFQ-së në xhir.1000-4300-70000-518, e nëse nuk e paguan në afatin e paraparë e njëjta do të ekzekutohet me denim burgu në kohëgjatje 30 (Tridhjet) ditësh, ditësh duke ia llogarit nga **15 €** në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse në emër të paushallit është i obliguar të paguaj shumën prej **5 €** në afat dhe gjyrollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobës dhe paushallit gjyqsor mund të bëhet në çdo bankë, ndërsa një kopje të kthehet në Gjykatë.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dërguar palës dhe ushtruesit të kërkesës.

## **A r s y e t i m**

Agjensioni Kundër korrupsionit në Prishtinë, ka ushtruar kërkesën nr.01-2281/10 të dt. 08.06.2010, për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartpërmendurit dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ftoi të pandehurin për dt. dt. 30.06.2010, mirëpo i njëjti edhe pse ftesën e ka pranuar nuk është paraqit në gjykatë, mirëpo përfaqsimin e ka bërë avokati i tij Bejtush Jusufi i cili gjykatës i deklaroi se i njëjti gjindet si këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Njyork, dhe i cili pohoi se është i informuar se materialin e ka marrë nga Agjensioni përkatës kundër korrupsionit dhe të njëjtin e ka dërguar por me vonesë dhe kjo ka ndodhur për shkak se ka qenë i preokupuar me punë në Ambasadën e Kosovës në Njo jork, dhe rreth vendosjes së familjes së tij si dhe punëve të ngarkuara që është autorizuar nga Ministria e Punëve të Jashme si Këshilltar dhe këto ka qenë arsyet të cilat kan penguar kryrjen e punëve të cilat i ka kërkuar Agjenisoni kundër korrupsionit.

Me dt. 01.07.2010, gjykatës i ka arrit një shkresë nga i pandehuri që është dërguar në tri faqe të formatit A-4, dhe që është shkruar me dt. 29.qershor 2010 në Njy Jork, i cili paraqet arsyetimet e tij se ka qenë i penguar në kryerjen e obligimeve të tija që e ngarkon ushtruesi i fletëparaqitjes.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka marrë në pyetje përfaqsesin e ushtruesit të fletëparaqitje të dt. 30.06.2010, i cili deklaroi, se ne u kemi dërguar të gjithë personat të cilët jan të obliguar sipas ligjit që të

\*\*\*\*\*